



2021

RAPORT – TM4 -2021



K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A

Rr. Wesley Clark p.n. Prizren 20000

www.hidroregjioni-jugor.com

PËRMBAJTJA

Zonat e përgjegjësish të K.R.U. „HIDROREGJIONI JUGOR”	4
---	---

	5
--	---

I. RAPORTI I DEPARTAMENTIT TEKNIK	5
--	----------

1.1 Performancat	5
-------------------------	----------

1.1.1 Situata e furnizimit – TM4 - 2021	5
---	---

1.1.2 Aktivitetet kryesore	6
----------------------------	---

1.1.3 Problemet e hasura gjatë kësaj periudhe	9
---	---

1.1.4 Masat e realizuara/ mos realizuara nga periudha paraprake	9
---	---

1.1.5 Masat e propozuara për periudhën në vazhdim	9
---	---

II. RAPORT I DEPARTAMENTIT RAJONAL PËR KONSUMATORË	10
---	-----------

2.1 Performancat	10
-------------------------	-----------

2.1.1 Numri i konsumatorëve TM3 - TM4 - 2021	10
--	----

2.1.2 Faturimi m ³ - TM3 - TM4 - 2021	10
--	----

2.1.3 Faturimi € - TM3 - TM4 - 2021	11
-------------------------------------	----

2.1.4 Arkëtimi € - TM3 - TM4 - 2021	11
-------------------------------------	----

2.2 Komentet kryesore nga DPK- TM3 - TM4 - 2021	12
---	----

2.2.1 Aktivitetet kryesore- TM3 - TM4 - 2021	12
--	----

2.2.2 Raport i ankesave teknike dhe komerciale	12
--	----

2.2.3 Raport i Ekipes së inspektimit dhe shkyçjes	12
---	----

2.2.4 Problemet e hasura gjatë kësaj periudhe	13
---	----

2.2.5 Masat e realizuara/ mos realizuara nga periudha paraprake	13
---	----

2.2.6 Masat e propozuara për periudhën në vazhdim	14
---	----

2.2.7 Aktivitetet për zvoglimin e UPF-se	14
--	----

III. RAPORT I DEPARTAMENTIT FINANCIARË	15
---	-----------

3.1 Performancat	15
-------------------------	-----------

3.1.1 Shpenzimet – TM3 - TM4 - 2021	15
-------------------------------------	----

3.1.2 Performancat kryesore TM3 - TM4 - 2021	15
--	----

3.1.3 Aktivitetet kryesore – TM3 - TM4 - 2021	15
---	----

3.1.4 Arsyeshmëria e shpenzimeve	16
----------------------------------	----

3.1.5 Problemet e hasura gjatë kësaj periudhe	17
---	----

3.1.6 Masat e realizuara nga periudha paraprake	17
---	----


3.1.7 Masat e propozuara për periudhën në vazhdim	18
---	----

3.2 Transaksionet kryesore	18
----------------------------	----

IV	Raport i Departamentit të Administratës	19
V	Raport i Auditorit të brendshëm	29
VI	Raport i Zyrës së Prokurimit	30
	ORGANOGRAMI	34

ZONAT E PËRGJEGJËSISË SË K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A

Mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit,viti 2021



LEGJENDA:	
05	Zona e shërbimit
05	Qytetet me ujë
75	Fshatrat me ujë që menaxhohen nga HRJ
118	Venbanimet pa shërbime të ujësjellësit

I. RAPORT I DEPARTAMENTIT TEKNIK

1.1 PERFORMANCAT TEKNIKE

KRU „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A – PRIZREN

Tabela:1 PRODHIMI – TM3- TM4- 2021

TM3-TM4- 2021				
K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A - PRIZREN				
PRODHIMI - m3				
NJËSIA PUNUESE	TM3-2021		TM4-2021	
	l/sec	m3	l/sec	m3
PRIZREN	485.8	3,819,900	332.9	2,617,500
SUHAREKË	82.1	645,400	78.6	618,200
MALISHEVË	41.0	322,462	39.8	313,200
DRAGASH	35.6	280,283	32.4	254,800
TOTAL	644.6	5,068,045	483.8	3,803,700
NDRYSHIMI l/sec			(160.81)	(1,264,345)
NDRYSHIMI %				-24.95%

1.1.1 SITUATA E FURNIZIMIT – TM4 2021

Furnizimi i konsumatorëve me ujë të pijes brenda 24 orëve në ditë, për muajt Tetor-Dhjetor të vitit 2021, në nivel regional, duke përfshirë të gjitha njësitë punuese e operuese, ka qenë kryesisht i rregullt por i shoqëruar me ulje presioni në disa zona më problematike edhe reduktime parciale të furnizimit.

Në NJP – Prizren, reduktimet janë aplikuar në qytetin e Prizrenit në disa zona (disa zona të qendrës së qytetit dhe zonat e lagjeve „Bajram Curri“, „Jeta e Re, pjesërisht „Arbana“) sikurse edhe reduktime parciale në disa pjesë rurale. Në njësitë tjera operuese, Suharekë, Malishevë dhe Dragash nuk janë shfaqur probleme të theksuara të furnizimit me ujë të pijes në pjesët urbane, me përjashtim të aplikimit të reduktimeve parciale të planifikuara në disa zona rurale.

Faktori kryesor që ka ndikuar drejtpërdrejtë në destabilizimin e furnizimit me ujë të pijes dhe vazhdon të ndikojë është zvogëlimi i kapaciteteve të burimeve ujore si rezultat i kushteve shumë të pavolitshme atmosferike për resurset ujore që kanë mbretëruar për një periudhë të gjatë kohore dhe vazhdojnë të mbretërojnë aktualisht. Faktorët tjerë gjithashtu me ndikim serioz në vështirësitë e furnizimit, uljen e presionit dhe aplikimin e reduktimeve janë keqpërdorimet enorme të ujit të pijes, defektet të shumta si pasojë e infrastrukturës parciale tejet të amortizuara dhe ndërprerjeve të shpeshta të planifikuara dhe të paplanifikuara të energjisë elektrike nga KEDS-i.

Në muajt Tetor-Dhjetor, bazuar në faktorët e sipërhënuar, përkundër vështirësive të sipërevidentuara, në përgjithësi kemi realizuar furnizimin kualitativ me objektiv në arritjen e standardeve aplikative të cilësisë 100% të ujit të pijes dhe janë ndërmarrë aktivitetet e duhura në operimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimit.

1.1.2 **AKTIVITETET KRYESORE**

- Angazhimet dhe menaxhimet e përditshme të punëve në përputhje me detyrimet dhe përgjegjësitë e vendit të punës dhe jashtë tij për operim dhe funksionimit optimal të Departamentit Teknik dhe Kompanisë.
- Takimet e rregullta të menaxhmentit, takimet me donatore, me institucionet komunale, qeveritare, me konsumator etj.
- Shkëmbimet e shkresave përmes komunikimeve elektronike e fizike, harmonizimi i projekteve investive dhe dokumentacioneve përkatëse teknike me të gjitha Institucionet financiare e tjera, përpilimi dhe finalizimi i projekt propozimeve të përgatitura nga DT. Të përfunduara dhe në ekzekutim e sipër 7 marrëveshje bashkë investuese me komunat brenda zonës menaxhuese të Kompanisë.
- Angazhimi si anëtar i komisionit ekzekutiv SHUKOS & SHUKALB rreth përgatitjes së Konferencës së Ujit, e paraparë për Nëntor 2021.
- Pjesëmarrja në konferencën e ujit në platformën dixhitale, prej 03 – 05.11.2021, si moderator i sesionit teknik dhe angazhimi në cilësinë e anëtarit të komisionit ekzekutiv SHUKOS & SHUKALB për Konferencën e Ujit.
- Mbikëqyrja profesionale dhe përfundimi i projektit „Stacioni pompues – Topallnica dhe njësitë tjera operuese brenda NJP-Suhareke“.
- Shqyrtimi dhe analizat profesionale të sistemeve elektropompues dhe përgatitja e dokumentacionit teknik për prokurim për elektropompa, vegla pune dhe makineri e mekanizëm përcjellës.
- Auditimet dhe evaluimet teknike me bashkëpunëtorët e DT të raporteve për institucionet kompetente dhe projekteve të papërfunduara, ato në ekzekutim e sipër, aplikacionet softwerike dhe menaxheriale, etj.
- Aplikimi dhe procedimi i shkresave zyrtare që lëshon DT - Përgjigjeve në kërkesa, Lejeve, Vendimeve dhe Pëlqimeve komfor Rregulloreve të Kompanisë.
- Vazhdimi i kryerjes së detyrave të punës nga pozicioni paraprak në cilësinë e menaxherit të projekteve dhe menaxhimi i kontratave me Telekom, IPKO, KEDS e operator tjerë, evidentimi dhe procesimi për pagesë të shpenzimeve mujore energjetike e telekomunikuese, ofrimin e zgjidhjeve teknike, hartimin e paramasave e paralogarive, kujdesi për mbarëvajtjen operative të infrastrukturës fizike të njësisë punuese të Kompanisë.

Aktivitet e shërbimit teknik të ndërmarra për eliminimin e humbjeve teknike.

- ✚ Identifikimin dhe mënjanimin e lidhjeve ilegale.
- ✚ Rehabilitimin e rrjetit të vjetër të qytetit për eliminimin e humbjeve teknike – dedektimi i rrjetit të ujësjellësit dhe ndarja e zanave për dedektim.
- ✚ Ngritjen e vetëdijes të të gjithë konsumatorëve që ta paguajnë ujin në mënyrë që të rritet inkasimi dhe të kemi mbulueshmeri financiare e cila do të kthehet konsumatorëve në shërbime dhe investime për shërbim sa më efikas të furnizimit me ujë të pijes.

Tabela:2 Mirëmbajtja e rrjetit – Sanimi i defekteve / Tetor - Dhjetor, 2021

Njësia Operative	Ujësjiellësi - uji i pijes	Kanalizimi	Total
Prizren	516	146	662
Suharekë	123	33	156
Dragash	16	15	31
Malishevë	139	23	162
Total	794	217	1011

Zyra për planifikim dhe zhvillim – Tetor - Dhjetor, 2021

- * Përpilimi i raportit të muajit Tetor-Dhjetor, 2021.
 - * Përpilimi i pëlqimeve, përgjigjeve në kërkesa për konsumatorët.
 - * Përpilimi i Plan Bisnesit 2022-2024.
 - * Përpilimi i dokumentacionit për SCADA SISTEM dhe përcjellja e tyre të Adrian Kiss.
 - * Revidimi i listës për rehabilitimin e rrjetit të kanalizimit Faza V.
 - * Vizita zyrtare për trajnim “UMT”, Republika Çeke .
 - * Pjesëmarrja virtuale në Konferencën e ujërave.
 - * Pjesëmarrja në platformën e MIA.
 - * Pjesëmarrja në platformën e UBP.
 - * Plotësimi i pyetësorit nga Ministria e Mjedisit (pjesa e D.T).
 - * Takim për cilësinë e ujit në Prishtinë .
 - * Përpilimi i dokumentacionit për SCADA SISTEM dhe përcjellja e tyre të Adrian Kiss.
 - * Pjesëmarrja në dëgjim publik për tarifa (ARRU dhe Hidroregjioni Jugor).
 - * Mbikëqyrje në projektet e Kompanisë.
 - * Rregullimi i rregullatorëve të shtypjes në fshatin Gjonaj.
 - * Vlerësimi i punëtorëve të D.T.
 - * Faza V dhe VI përgatitja e komenteve.
 - * Menaxhimi i kontratave në sistemin e Prokurimit.
 - * Përpilimi i projekt propozimeve nga HRJ.
 - * Matje gjeodezike dhe aktivitete të ndryshme profesionale për nevoja të kompanisë.
 - * Takim pune në K.Komunal për realizimin e projekteve të përbashkëta dhe atë që janë në plan nga K.Komunal si dhe mundësia e vazhdimi i bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve.
 - * Digjitalizimi i konsumatorëve në GIS për njësitë e Suharekës, Malishevës dhe Dragashit.
 - * Gjatë muajve Korrik-Shtator grupi ka vazhduar me përpunimin e të dhënave të terrenit, vendosjen e të dhënave në GIS.
- Databaza e konfiguruar nga ana e Shërbimit Teknik dhe MMS-Tool çdo ditë bëhen backup dhe ruhen në serverin e Kompanisë dhe në një Hardisk të jashtëm për rast sigurie.
- * Në muajt Tetor-Dhjetor, grupi i terrenit demontim – montim me njësi në Prizren kanë bërë gjithsej: 663 vizita të konsumatorët, 327 ndërrime të ujëmatësve dhe 81 riparime të defekteve. Ekziston raporti i veçantë.
 - * Grupi i detektimi të rrjetit të ujësjiellësit gjatë muajve Tetor-Dhjetor, ka bërë gjithsej 195 detektime, gjatë detektimit kanë hasur në 144 defekte, ekziston raporti i veçantë. Po ashtu gjatësia e rrjetit të detektuar është 4,870 m.
 - * Leximi i ujëmatësve zonal për muajt Tetor-Dhjetor.

Tabela:3 Bllombim të ujëmatësave

	Bllombim të ujëmatësave	Total
1	Bllombim-Kontrata	376
2	Ribllombime	01
3	Dera Mbyllur	1122
4	Kërkes nga konsumatori	32
5	Zevendesim	32
6	Regjistrim i ri	03

Raporti mbi cilësinë e ujit të pijes për muajt Tetor - Dhjetor nga Lab. i kompanisë

Aktivitetet tjera :

Kontrolli permanent i prezencës së klorit residual në kroje në qytet si dhe kontrollimi i klorit në fshatra.

Kontrolli permanent i kualitetit të ujit në burime si dhe të puseve të cilat shfrytëzohen për momentin.

Kontrolli i rregullt i stacioneve të klorifikimit mbi mbarvajtjen e procesit dhe paisjeve.

Marrja e mostrave sipas planit të monitorimit intern .

Furnizim i stacioneve të klorifikimit me Hipoklorit të Natriumit në të gjitha fshatrat.

Instaluar dhe futëm në funksion sistemin e klorinimit në „TOPALLNICË”-Suharekë.

Në stacionin e klorinimit në komorën e re në „40-Burime” riparuar Vakum rregullatorin dhe e rikthyem në funksion.

Në mënyrë sistematike kontolluar kualitetin e “Pusit 2” në Novak për disa ditë pa ndërprerë.

Jemi përgjigjur ankesës së konsumatorit për kualitet të ujit në Arbanë-Prizren.

Kemi pasur takim pune me përfaqësuesit e ARRU-së dhe i kemi furnizur me dokumentacionin e kërkuar nga ana e tyre.

Riparuar pompën e klorinimit si dhe vakumrregullatorin në komorën e re në “40-Burimet”.

Përcjellje permanente e kualitetit të ujit për shkak të rritjes së turbiditetit sidomos pas luhatjes së energjisë elektrike,

Me kërkesën e Menagjerit të ITU-të zeza kemi shkuar rregullish për disa ditë për ta përcjell sasinë e klorit në objekt dhe në qendrën e trajtimit të ujit.

Kemi pasur trajnim me të gjithë punëtorët të cilët janë të angazhuar me punë me Klor, të organizuar nga SHUKOSI DHE IKSHP-ja.

Tabela:4 Analizat Bakteriologjike, Tetor- Dhjetor / 2021

Njësia	Lloji i ujit	Nr. i mostrave bakteriologjike	Nr. i mostrave që nuk përgjigjen
Prizren	Burim	14	8
	Ujësjiellës	23	1
Suharekë	Burim	6	4
	Ujësjiellës	11	0
Dragash	Burim	3	3
	Ujësjiellës	8	2
Malishevë	Burim	2	2
	Ujësjiellës	11	0
Totali		78	3

Vrejtje: 1) Në burim, uji i patrajtuar ; 2) Ujësjiellës, uji i trajtuar

Tabela:5 Analizat Bakteriologjike, ISHP-Prizren, Tetor- Dhjetor / 2021

Njësia	Lloji i ujit	Nr. i mostrave bakteriologjike	Nr. i mostrave që nuk përgjigjen
Prizren	Burim	10	0
	Ujësjiellës	208	0
Suharekë	Burim	2	0
	Ujësjiellës	28	0
Dragash	Burim	0	0
	Ujësjiellës	12	0
Malishevë	Burim	2	0
	Ujësjiellës	28	0
Totali		290	0

Vrejtje: Numri i analizave të mostrave bakteriologjike të marrura në rrjetin e ujësjiellësit është 276 mostra dhe të gjitha mostrat i përgjigjen standarteve të ISHP.

1.1.3 PROBLEMET E HASURA GJATË KËSAJ PERIUDHE

- Keqpërdorimi i ujit të pijes.
- Ndërprerja e herë pas herëshme e energjisë elektrike.
- Shpenzimet e mëdha të energjisë elektrike.

1.1.4 MASAT E REALIZUARA NGA PERIUDHA PARAPRAKE

- Te gjitha defektet në sistem të ujësjiellësit dhe kanalizimit janë sanuar me kohë,
- Është përcjell në mënyrë permanente cilësia e ujit të pijes në nivel regional,
- Është përgatitur dhe miratuar strategjia e UPF-së.

1.1.5 MASAT E PROPOZUARA PËR PERIUDHËN NË VAZHDIM

Monitorimi i furnizimit me ujë të pijes në gjithë zonën e shërbimit,

- Monitorimi i cilësisë së ujit të pijes në nivel regional,
- Vazhdimi i analizës së rrjetit të ujësjiellësit dhe kanalizimit si dhe bartja e të dhënave në GIS,
- Fillimi i implementimit të strategjisë për uljen e UPF-së.

*Aktivitetet e shërbimit teknik të ndërmarra për eliminimin e humbjeve teknike.

- ✚ Identifikimin dhe mënjanimin e lidhjeve ilegale.
- ✚ Rehabilitimin e rrjetit të vjetër të qytetit për eliminimin e humbjeve teknike – dedektimi i rrjetit të ujësjiellësit dhe ndarja e zanave për dedektim.
- ✚ Ngritjen e vetëdijes të të gjithë konsumatorëve që ta paguajnë ujin në mënyrë që të rritet inkasimi dhe të kemi mbulueshmeri financiare e cila do të kthehet konsumatorëve në shërbime dhe investime për shërbim sa më efikas të furnizimit me ujë të pijes.

II. RAPORT NGA DEPARTAMENTI PËR KONSUMATORË

2.1 PERFORMANCAT

2.1.1 NUMRI I FATURAVE TË LËSHUARA – TM3-TM4 – 2021

Tabela:6

NUMRI I FATURAVE TË LËSHUARA			
No.	Të dhënat	TM3- 2021	TM4-2021
1	Shtëpiak	47,185	47,585
2	Ndryshimi		400
3	Ndryshi. %		0.85%
4	Kome.-Indu.	6,120	6,180
5	Ndryshimi		60
6	Ndryshi. %		0.98%
7	Institucional	336	339
8	Ndryshimi		3
9	Ndryshi. %		0.89%
10	TOTAL	53,641	54,104
11	Ndryshimi		463
12	Ndryshi. %		0.86%

2.1.2 FATURIMI m3 – TM3-TM4 – 2021

Tabela:7

FATURIMI - m3			
No.	Të dhënat	TM3- 2021	TM4- 2021
1	Shtëpiak	2,014,143	1,490,727
2	Ndryshimi		(523,416)
3	Ndry. %		(26.0)
4	Kome.-Indu.	194,723	151,142
5	Ndryshimi		(43,581)
6	Ndry. %		(22.4)
7	Institucional	110,449	111,498
8	Ndryshimi		1,049
9	Ndry. %		0.9
10	TOTAL	2,319,315	1,753,367
11	Ndryshimi		(565,948)
12	Ndry. %		-24.40%

2.1.3 FATURIMI - € - TM3-TM4- 2021

Tabela:8

FATURIMI - €			
No.	Të dhënat	TM3- 2021	TM4- 2021
1	Faturimi-€	1,526,389.46	1,219,991.46
2	Total- Shte.	1,179,165.74	914,051.26
3	Ndryshimi		(265,114.48)
4	Ndry. %		-22.5%
5	Total- kome.	234,736.41	192,441.02
6	Ndryshimi		(42,295.39)
7	Ndry. %		-18.0%
8	Total-Inst.	112,487.31	113,499.18
9	Ndryshimi		1,011.87
10	Ndry. %		0.9%
11	Te tjera	25,478.70	31,221.71
12	Total	1,551,868.16	1,251,213.17
13	Ndryshimi		(300,654.99)
14	Ndry. %		-19.4%

2.1.4 ARKËTIMI - € - TM3-TM4- 2021

Tabela:9

ARKËTIMI - €			
No.	Të dhënat	TM3- 2021	TM4- 2021
1	Total- Shtëpiak	1,115,579.22	963,222.25
2	Ndryshimi		(152,356.97)
3	Ndry. %		-13.7%
4	Total-Komercial-Industrial	206,653.18	189,657.39
5	Ndryshimi		(16,995.79)
6	Ndry. %		-8.2%
7	Total Institucional	115,472.44	140,885.35
8	Ndryshimi		25,412.91
9	Ndry. %		22.0%
10	Total - ujë	1,437,704.84	1,293,764.99
11	Ndryshimi		(143,939.85)
12	Ndry. %		-10.0%
13	Te tjera	19,808.41	12,408.47
14	Ndryshimi		(7,399.94)
15	Ndry. %		-37.4%
16	TOTAL	1,457,513.25	1,306,173.46
17	Ndryshimi		(151,339.79)
18	Ndry. %		-10.38%

2.2 KOMENTET NGA SHËRBIMI PËR KONSUMATORË

2.2.1 AKTIVITETET KRYESORE

- Kemi një faturim më të vogël se në krahasim me TM paraprak , pasi që kemi rënie të konsumit sezonal.
- Kemi një rënie të inkasimit nga tremujori paraprak në vlerë absolute edhe pse në përqindje kemi rritje , kjo ka ndodhë si rezultat i rënies së faturimit nga rënia e konsumit.
- Janë shtyp dhe shpërnda faturat e shërbimeve të ujësjellësit brenda afatit ligjor te secili konsumatorë.
- Me kujdes të shtuar, janë vizituar nga lexuesit të gjithë konsumatorët në pronat e tyre ku është kërkuar inkasimi i mjeteve për shërbimet e ujësjellësit.

2.2.2 ANKESAT TEKNIKE DHE KOMERCIALE

- Janë shqyrtuar të gjitha ankesat teknike ndërsa ankesat komerciale të konsumatorëve janë shqyrtuar sipas prioritetit të tyre.
- Janë shqyrtu ankesat teknike dhe komerciale në nivel rajonal:

Tabela:8

Ankesat Teknike dhe Komerciale – TM4 2021		
Ankesat Teknike për Shërbimet e Ujit dhe Kanalizimit	numër	723
Ankesat Teknike të Shqyrtuara me Kohë	numër	723
Ankesat Komerciale për Shërbimet e Ujit dhe Kanalizimit	numër	176
Ankesat Komerciale të Shqyrtuara në Kohë	numër	176
Ankesat Komerciale të Zgjidhura me Kohë	numër	176

2.2.3 RAPORT NGA EKIPET E INSPEKTIMIT

Aktivitetet dhe punët të cilat i mbulon inspektorati janë si në vijim:

- Aktivitet kryesore të inspektoratit në punët e përditshme janë: inspektimi konsumatorëve rreth konsumit të ujit, lidhjeve ilegale, kontrollimin e leximit të ujëmatësve nga konsumatorët , identifikimin dhe legalizimin e konsumatorëve të cilët janë kyçur në rrjet, shkyçjen e kyçjeve të paautorizuara, shpërndarjen e njoftimeve p[ara inicimit të procedurës përmbartimore, shkyçjen e konsumatorëve të cilët janë debitor të kompanisë etj. Sa i përket planit të punës së tyre , në fillim të çdo muaji mbikëqyrësit e ekipeve shtypin listën e konsumatorëve për secilin ekip të cilët duhet të inspektohen brenda muajit. Më pastaj secili ekip del në teren dhe inspekton konsumatorët sipas listës . Kështu në çdo fillim muaji shtypen lista me konsumatorët të rinjë dhe i'u jepet secilit ekip për inspektim në teren. Numri i përgjithshëm i konsumatorëve inspektohet brenda periudhës kohore prej 14-16 muajve dhe kështu fillohet që nga fillimi.

Planifikimi i punës së tyre bëhet varësisht nga analizat që bëhen nga mbikëqyrësit e tyre ku bëhet edhe prioritetizimi i tereneve për inspektim.

- Kanë vazhduar kontrollet në teren te konsumatorët nga ekipi i inspektimit dhe verifikimet tek konsumatorët dhe aktivitetet janë te prezantuar ne tabelën e mëposhtme:

TM4-2021

Tabela:9

Njesite operative	Shperndarja e njoftimeve paralajmëuese per permbarim	Konsumatorët e legalizuar	Lidhjet e paligjshme te zbuluara	Nr. i shkyçjeve te lidhjeve te paligjshme	Verifikimi i leximit te ujëmatësve	Nr. i leximeve te gabuara	Rastet e dorezuar per gjykatë	Shuma e arketuar nga borxhet e akumuluar
Prizren	3,029	376	1	1	1,937	18	0	49,733.14
Suharekë	365	29	1	1	2,422	0	0	21,491.00
Malishevë	227	0	4	18	134	28	0	0
Dragash	0	0	2	2	46	0	0	20.00
TOTAL	3,421	405	8	22	4,539	46	0	71,244.14

2.2.4 PROBLEMET E HASURA GJATË KËSAJ PERIUDHE

- Pamundësia e faturimit real nga lexuesit te një numër i caktuar i konsumatorëve pasi që ujëmatësit janë amortizuar dhe nuk regjistrojnë sasinë reale të shpenzimit të ujit.
- Mos pagesa e obligimeve te kontraktuara nga një pjese e madhe e konsumatorëve të cilët kanë nënshkruar kontratë për pagesën e borxheve me këste si rezultat i pamundësisë dhe rënies së fuqisë financiare te familjet e tyre nga Covid 19.
- Vazhdon problematika e mos zgjidhjes së problemit të rasteve sociale, kjo kategori e konsumatorëve po ndikon në mungesën e inkasimit te kjo kategori e konsumatorëve. Ky numër vazhdon të rritet për çdo muaj dhe konsiderojmë që ky numër në teren është mjaft i madh, sidomos gjatë kësaj periudhe të pandemisë.
- Moszgjidhja e çështjes së borxheve të mëhershme, trashëgimi i borxheve në prona.
- Moszgjidhja e problemit të borxhit për shpenzimet e ujit mes shitësit dhe blerësit të pronës, pronave të uzurpuara që nga pas lufta, pronat që kanë qenë nën administrimin e Agjencionit Kosovar të Pronës.

2.2.5 MASAT E REALIZUARA NGA PERIUDHA PARAPRAKE

- Kanë vazhduar punën, arka mobile dhe inkasimi nga inspektorati në njësinë e Prizrenit dhe njësive tjera për pagës te konsumatorët të cilët nuk kanë paguar mbi 6 muaj.
- Vazhdon implementimi i Up-grade (avansimi i softverit), për faturim, arkat për pagesa dhe departamente tjera në Kompani.
- Kemi një rritje të numrit të konsumatorëve si rezultat i pëlqimeve për kyçe dhe legalizimeve.

- Kemi një rënie në inkasim në krahasim me muajin paraprak, si rezultat i mos pagesës së obligimeve nga ana e konsumatorëve. Kjo rënie ka ndodhë si rezultat i mos pagesës së obligimeve nga ana e institucioneve, pasi që ende nuk janë lëshuar mjetet nga thesari.
- Aktivitete me përmbaures privat (dalja në teren me ekipet e kontrollit, identifikimi i adresave, identifikimi i konsumatorëve, trashëgimtarëve të tyre etj.), janë ndërprerë gjatë kësaj periudhe.
- Nuk janë shpërnda njoftime para inicimit të procedurës përmbaures në terrenet e inkasantëve në qytet .
- Janë vizituar konsumatorët të cilët kanë ngec në pagesën e kësteve nga kontratat për pagesën e borxhit me këste, mirëpo të kjo kategori janë dërguar mesazhe përmes telefonit ku është kërkuar pagesa kësteve të papaguara dhe obligimeve rrjedhëse.

2.2.6 MASAT E PROPOZUARA PËR PERIUdhËN NË VAZHDIM

- Në pajtim me masat nga Qeveria për Covid 19, do të vazhdohet me punët sipas normalitetit do të vijojn aktivitetet si në vazhdim:
 - Vazhdimi i dërgimit të rasteve në përmbaures
 - Vazhdimësi e thirrjeve me telefon dhe dërgimi i mesazheve përmes telefonit të konsumatorët të cilët nuk i përmbahen kontratës.
 - Dërgimi i vërejtjeve për ndërprerje të shërbimit të konsumatorët pa ujëmatës.
 - Trajtimi i një numri më të madh të konsumatorëve në teren, shpërndarja e paralajmërimeve para inicimit të rasteve të përmbaures duke i ndërruar terrenet e inkasantëve.
 - Vizita më të shpeshta të konsumatorët e bizneseve të cilët kanë borxhe, ata të cilët kanë bërë kontratë e të cilët nuk i përmbahen pagesës së kisteve.
 - Vazhdimësia e mbështetjes së inkasantëve nga ekipi i kontrolles të konsumatorët të cilët në vijimësi nuk paguajn faturat.
 - Mbikqyrja dhe monitorim i vazhdueshëm i inkasantëve në arritjen e limitive në inkasim
 - Regjistrimi i vazhdueshëm i konsumatorëve që dëshirojnë të kyqen në shërbime të ujësjellsit dhe kanalizimit.

2.2.7 AKTIVITETET PËR ULJEN E UPF-së

- **Identifikimi i konsumatorëve ilegal, legalizimi i tyre dhe shkyçja e konsumatorëve problematik (lidhjeve ilegale dhe shfrytëzimit të paautorizuar të ujit);**
- Janë identifikuar, i është dhënë pëlqime dhe legalizuar 405 konsumatorë.
- Jane zbuluar dhe shkyq 4 kyqje të paautorizuara gjatë periudhës raportuese.
- **Identifikimi dhe procedimi penal i konsumatorëve problematik (ilegal apo që vjedhin ujin)**
- Kemi procedu 32 raste në gjykate.

III. RAPORT NGA DEPARTAMENTI I FINANCAVE

3.1 PERFORMANCAT

3.1.1 SHPENZIMET - € - TM3-TM4 - 2021

Tabela:10

SHPENZIMET - €			
No.	Të dhënat	TM3- 2021	TM4- 2021
1	Total Shpenzimet Operative	939,826.36	1,071,689.88
2	Pagat	556,078	603,424
3	Rryma elektrike	224,861	259,728
4	Shpen. e derivateve	27,587	32,686
5	Mirem. dhe riparimet	39,632	28,657
6	Mirem. e automjeteve	17,647	25,662
7	Shpen.e taksave	26,295	25,853
8	Kemikaliet	5,341	4,226
9	Shpenzimet e tjera	42,386	91,454
2	Ndryshimi		131,863.52
3	Ndryshimi ne %		14.03%

3.1.2 PERFORMANCAT KRYESORE- TM3-TM4-2021

Tabela:11

Treguesit e Performancës	[Njësia]	TM3-2021	TM4-2021
Ujë i faturuar-si përqindje	%	45.76%	46.10%
Ujë i pafaturuar-si përqindje	%	54.24%	53.90%
Norma e arkëtimit - e përgjithshme	%	94.19%	106.05%
Norma e Mbulimit operativ	numër	1.55	1.22

3.1.3 AKTIVITETET KRYESORE

Ky raport përfshinë disa aktivitete nga shërbimi financiar në pika të shkurtra, aktivitete të cilat janë konform rregullores së punës së kompanisë si dhe ligjeve në fuqi. Duke u nisur nga regjistrimet e rregullta

dhe të drejta sipas ligjeve në Kosovë e deri te aktivitetet tjera për një përformacë sa më të mirë të kompanisë, dhe disa nga to janë:

- Përgatitja e raporteve tremujore për TM4 2021;
- Kontrollimi dhe barazimi i të pagueshmeve dhe atyre të arkëtueshmeve,
- Përgatitja e raporteve mujore financiare, si inkasimin, të hyrat dhe ato të shpenzimeve, gjithashtu edhe raportet tremujore;
- Hapja dhe përgatitja e pagave për muajt përkatës, kontrollim, barazim dhe verifikim të regjistrit të të punësuarve;
- Raportet ditore nga shërbimi i arkës, gjendjen e arkës në lidhje me inkasimet ditore, ato të amvisërisë, bizneseve, gjendjen e llogarive bankare, kontimin e tyre, barazimet etj.
- Kontrollimi dhe nënshkrimi i kërkesave për blerje, si dhe aprovimi i tyre për blerje;
- Kontrollimi dhe pranimi i faturave për blerjet si dhe regjistrimi i tyre në kontabilitet, pas kontrollimeve;
- Pagesa e furnitorëve, pas kontrollimit të blerjeve; barazimi i të pagueshmeve;
- Plotësimin e librave të blerjes dhe shitjes sipas ligjeve dhe formës standarde të kërkuar nga ATK, për muajt përkatës, mujor e tremujor;
- Deklarimet e tatimeve, TVSH-së, tatimet e pagave etj., sipas ligjeve në fuqi;
- Raportimet tremujore ndaj ARRU-së
- Raportimet tremujore ndaj njësisë për ndërmarrjet publike;
- Raportimet tremujore ndaj Agjensisë së Statistikave të Kosovës;
- Regjistrimet e fund vitit, mbylljen e raporteve;

3.1.4 ARSYESHMERIA E SHPENZIMEVE

Shpenzimet operative të ndërmarrjes për tre mujorin e IV-të 2021, në krahasim me shpenzimet e tremujorit të III-të 2021, janë dukshëm më të larta.

Më poshtë do t'i cekim disa nga pozicionet, të cilat kanë lëvizur më së shumti dhe arsyet e rritjes apo uljes së tyre;

Në pozicionin e pagave kemi një rritje të shpenzimeve, kjo rritje ka ardhur për shkak se, në muajin nëntor 2021, me vendim të bordit të drejtorëve, është bërë rritja e vlerës së koeficientit nga 85 euro në 90 euro. Gjithashtu, në muajin dhjetor është dhënë shpërblim për ndër të festave të fund vitit për të gjithë punëtorët në vlerë neto prej 50 €. Pra të gjitha këto kanë ndikuar në rritje të pagave në këtë tremujor në krahasim të tremujorit të kaluar;

Edhe në pozicionin e energjisë elektrike kemi një rritje të shpenzimeve, në veçanti në njësinë e Prizrenit, për shkak se në muajin shtator dhe tetor, një nga pikat e pompave tek Bunari I, nuk janë faturuar komplet muajt nga KEDS-i për arsye teknike të tyre dhe për ndryshimin e muajve të kaluar jemi faturuar në muajin nëntor. Pra kjo ka ndikuar në rritje të shpenzimeve për këtë tremujor;

Gjithashtu edhe te pozicioni i derivateve kemi një rritje të shpenzimeve, përveç që është rritur edhe çmimi i derivateve, kemi bërë furnizim të naftës edhe për Impiantin e Ujërave të Ndotura dhe për ngrohje qendrore;

Ndërsa te pozicioni i mirëmbajtjes dhe riparimeve, dhe mirëmbajtjen e pompave, kemi rënje të kësaj kategorie të shpenzimeve, për shkak se në këtë tremujor nuk ka pasur shumë intervenime në mirëmbajtje se sa tremujori i kaluar;

Por rritje kemi pasur edhe te pozicioni i mirëmbajtjes së automjeteve; në veçanti kemi rritje në Njësinë e Prizrenit, nevoja për intervenime në makinerinë e kompanisë ka qenë më e lartë, gjithashtu në këtë tremujor kemi pasur edhe më shumë regjistrime të veturave;

Shpenzimet e taksave janë me të ulëta në këtë tremujor, pasi që shpenzimet për dërgimin e lëndëve në përmbartim kanë qenë më të ulëta, ndërsa shpenzimet e anëtarësisë në SHUKOS edhe ato të ARRU-së mbetën të njëjta;

Te shpenzimet tjera, ku përfshihen shpenzimet e administrates, shpenzimet e telefonisë, shpenzimet e udhëtimeve zyrtare, shpenzimet e interesit, shpenzimet e trajnimit të stafit të kompanisë etj, kemi rritje të këtyre shpenzimeve, pasi që në këtë tremujor, kemi regjistruar borgjin e Agjencisë të ujërave dhe pellgjeve lumore pranë Ministrisë së Ambientit, për vitet 2018-2020, pra kjo ka ndikuar direkt në rritjen e këtyre shpenzimeve;

Pra si përfundim, shpenzimet për këtë tremujor kanë qenë më të larta në krahasim me tremujorin e kaluar, për arsyt e cekura me lartë. Pra, pozicioni i pagave, i energjisë elektrike dhe shpenzimeve tjera kanë qenë këto pozicione që kanë ndikuar më shumë në rritjen totale të shpenzimeve;

3.1.5 PROBLEMET E HASURA GJATE KESAJ PERIUDHE

Duke e pare gjendjen financiare ne KRU Hidroregjioni Jugor Sh.A. Prizren, Kompania gjendet para tri problemeve të mëdha, respektivisht rreziqeve relativisht te mëdha:

- 1- **Vendimi i Gjykatës Themelore mbi borgjin e Kompanisë ndaj KEK** , për të cilin borgj ne kemi arrit marrëveshje me KEK-un për përmbushjen e obligimit për 12 vite . Obligimi vjetorë është 120,768.00 euro
- 2- **Pamundësia e inkasimit të llogarive të arkëtueshme** të vjetërsuara , ekziston rreziku i parashkrimit te borgjit . Duke u bazuar ne raportin financiar, kompania jonë ka kërkesa për llogari të arkëtueshme ne shumë prej **12,238,984.00** euro
Këto llogari të arkëtueshme , ekziston rreziku që shuma dërmuese të jenë borgje të këqija pasi që shuma prej 7,086,649.09 janë borgje të provizionuara .
- 3- **Detyrimet kontigjente -kërkesat e punëtorëve ndaj kompanisë** që kanë vendim gjykate shuma 94,000.00 euro. Ekzistojnë edhe detyrime tjera kontigjente por që ende nuk kanë epilogë gjykate.

3.1.6 MASAT E REALIZUARA NGA PERIUDHA PARAPRAKE

- Kompania ka arrit të që gjatë këtij tremujorë shi të përmbush obligimin ndaj ATK-së
- Hapat e ndërmarra: Kompania ka arrit marrëveshje për programimin e borxhit me KEK-un ,dhe atë që borxhi të paguhet për 144 këste mujore .Shuma e këstit është **10,064.00 euro**. Ne deri tani kemi arritur të përmbushim me sukses këtë marrëveshje .

3.1.7 MASAT E PROPOZUARA PËR PERIUdhËN NË VAZHDI

- Të bëhen përpjekje të vazhdueshme që të kërkohet ndihmë edhe nga ana e Qeveris së Kosovës përkatësisht MZHE. për ndihmë financiare në mënyrë që të përballohen këto probleme.
- Të bëhen përpjekje për inkasimin e llogarive të arkëtueshme para se ato të mundë të parashkruhen.

3.2 TRANSAKSIONET KRYESORE

3.2.1 pagesat me te medha nga Hidroregjioni Jugor per Operatoret TM4 2021

Tabela:12

NR.	DATA	PERSHKRIMI	SHUMA
1	23/12/2021	P2M Berlin GmbH	85,290.45
2	23/12/2021	P2M Berlin GmbH	72,512.93
3	20/12/2021	P2M Berlin GmbH	67,181.77
4	20/12/2021	P2M Berlin GmbH	57,227.00
5	20/12/2021	P2M Berlin GmbH	56,790.01
6	17/12/2021	KEK - Bunari I	53,394.91
7	23/12/2021	P2M Berlin GmbH	52,392.21
8	20/12/2021	P2M Berlin GmbH	51,777.24
9	22/10/2021	Burimi-Com sh.p.k.	49,176.39
10	23/12/2021	Hiterm EL	48,026.70
	TOTAL		593,769.61 €

3.2.2 pagesat me te medha ndaj Hidroregjioni Jugor per TM4 2021

Tabela:13

NR.	DATA	Nr. I DOKUMENTIT	PERSHKRIMI	SHUMA
1	25.06.2020	NLB	Subvencion - Qeveria	400,000.00
2	15.04.2020	PCB	200000215/4444	16,592.29
3	18.05.2020	NLB	200000216/4444	13,885.84
4	17.04.2020	BpB	200000217/4444	13,188.85
5	22.04.2020	NLB	200000218/4444	11,743.06
6	05.06.2020	NLB	200000219/4444	10,115.05
7	27.05.2020	PCB	200000220/4444	7,437.63
8	08.06.2020	PCB	200000221/4444	6,881.95

9	04.06.2020	PCB	200000222/4444	6,555.35
10	11.06.2020	PCB	200000223/4444	5,076.65
			Totali	491,476.67

IV RAPORT NGA DEPARTAMENTI ADMINISTRATIV

Departamenti i administratës gjatë këtij tremujori është marr me përgatitjen e raporteve dhe informatave nga veprimtaria e shërbimit juridik, varësisht nga detyrat dhe obligimet e punës të parapara për këtë departament.

- Gjatë këtij tremujori janë përgatitur të gjitha procesverbalet dhe vendimet e dala nga Bordi i Drejtorëve, Komisioni i Auditimit dhe UD Kryeshefi Ekzekutiv.
- Pas përgatitjes së Procesverbaleve të Bordit, Komisionit të Auditimit, janë njoftuar të gjitha shërbimet (udhëheqësit) lidhur me rekomandimet e Bordit dhe raportet e kërkuara nga mbledhjet në fjalë.
- Shërbimi juridik ka përgatitur kontratat në mes të kompanisë dhe palëve të treta nga fusha e veprimtarisë së Kompanisë.
- Gjithashtu ky shërbim lëshon për të punësuarit të gjitha llojet e aktvendimeve, autorizimeve dhe vërtetimeve nga fusha e marrëdhënieve të punës.
- Nga zyra ligjore është bërë përfaqësimi i Kompanisë në Gjykatën Themelore të Prizrenit, Malishevës, Dragashit dhe Suharekës si dhe është punuar intensivisht në procedimin e lëndëve të përbaruesit privatë për secilën njësi punuese, lëndë këto që kanë të bëjnë me konsumatorët e amvisërisë dhe bizneset që kanë borxh ndaj shërbimeve të ujësjellësit.
- Aktvendimet për pushime vjetore janë lëshuar pas kërkesës me shkrim të punëtorëve dhe aprovimin apo pëlqimin nga udhëheqësit e tyre.
- Me autorizim të u.d së KE janë përgatitur Vendime për mbikëqyrje të punimeve dhe pranim teknik për projektet e investuara me mjetet vetanake të Kompanisë dhe nga buxheti i Komunave të njësive punuese sipas kërkesës së shërbimit teknik.
- Me Vendim janë formuar Komisionet për regjistrim vjetor 2021 që përfshin: Komisioni për regjistrimin e mjeteve themelore, veglave të rënda dhe inventarit të imët; Komisioni për regjistrimin e lëndëve të para dhe materialit në depon kryesore dhe në servis in e bazhdarimit; Komisioni për regjistrimin e arkës, porto-arkën, kërkesit dhe blerësit dhe Komisionin Qendror të regjistrimit. Të gjithë komisionet e regjistrimit do të kryejnë regjistrimin prej 29.12.2021 gjerë më 10.01.2022 dhe në fund do të kryhet barazimi me gjendjen e kontabilitetit dhe raporti do të dorëzohet komisionit qendror. Komisioni qendror është i obliguar të përpiloj raport mbi kryerjen e të njëjtës dhe t'ia dorëzoj Kryeshefit Ekzekutiv gjerë më 15.01.2021.
- Nga udhëheqësit e departamenteve dhe mbikëqyrësit e drejtpërdrejtë të shërbimeve përkatëse të Kompanisë është bërë vlerësimi vjetor i performancës së secilit punonjës për kryerjen e detyrave të punës në Kompani gjatë viti 2021. Të gjitha vlerësimet e punonjësve për vitin 2021 janë regjistruar në dosjen e tyre në program Navision nga Zyrtarja për burimet njerëzore.

- Janë bërë vazhdime te kontratave te punëtorëve te Kompanisë te cilët kane qene ne afat të caktuar për një vit. Vazhdimi kontratës së punës është bërë pas vlerësimit të punës së tyre nga ana e udhëheqësve te sektorëve përkatëse.
- Në departament te administratës kemi pasur auditim nga Zyra nga Zyra Kombëtare e Auditimit.
- Është publikuar Konkursi për Kryeshef Ekzekutiv ne HRJ ne shtypin ditor “Bota sot e re”, “Portal pune” dhe “Burimet njerëzore” me datë 09.11.2021 si dhe shpallja e dytë është bërë në shtypin ditor “Bota sot e re” me datë 23.11.2021

Tabela:14 Pushimet e shfrytëzuara nga punonjësit gjatë TM-4/2021

Nr	Llojet e pushimeve	Ditët e shfrytëzuara
1	Pushim vjetor	134
2	Pushim mjekësor	47
3	Pushim pa pagesë	9
4	Pushim lehonisë	0
6	Kompanzim per gjendje te rend shendetsore 50% te pagës(punt.A.Topqideri)	1
7	Pushim për rast vdekje	7

Tabela:15 Raport i numrit të punëtorëve Tetor - Dhjetor, 2021

Nr.	Muaji	Hidroregjioni Jugor	Prizren				Suharekë	Dragash	Malishevë
			Prizren	Bordi	ITUN	Total			
1	TETOR	334	225	4	19	248	35	16	35
2	NENTOR	336	225	4	19	248	36	16	36
3	DHJETOR	335	225	3	19	247	36	16	36

Tabela:16 Numri i punëtorëve sipas departamenteve dhe moshë mesatare e punonjësve ne HRJ

DEP. Administratë	DEP. Financave	DEP. Teknik	DEP. Konsumator	DEP. Itun	Nj. Suharekë	Nj. Malishevë	Nj. Dragash	Moshë mesatare HRJ
44	15	87	79	19	36	36	16	46.8

Tabela:17 PERSONELI – TETOR– DHJETOR 2021

Muajt	Nr. i te punësuarve sipas muajve	Vende te plotësuar	Te larguar	Të pensionuar	Vërejtje
Tetor	330	1	2		Nga data 01.12.2021 pensionim i parakohëshëm,punt.A.Topqideri.
Nëntor	332	4		1	
Dhjetor	332	1	1		

Tabela:18 NUMRI I PUNËTORËVE SIPAS NACIONALITETEVE

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH. A					
Nacionaliteti	Shqiptarë	Boshnjak dhe Mysliman	Romë, Ashkali dhe Egjiptas	Turq	Gjithsejtë numri i punëtorëve
Numri i Punëtorëve	291	32	4	5	332
Numri i Punëtorëve në %	87.7	9.6	1.2	1.5	100

Tabela:19 NUMRI I PUNËTORËVE NË 1000 KONSUMATORË DHE SIPAS GJINISË

GJINIA:	NR	NR. %	Nr. Në 1000 Kon.
FEMRA:	44	13.25	
MESHKUJ:	288	86.75	
TOTAL	332	100.00	

Tabela:20 KUALIFIKIMI I PUNËTORËVE

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A								
KUALIFIKIMI								
Kualifikimi	Doktoratur	Master	Fakultet	Bachelor	Sh. e mesme	Shkolla fillore	Pa shkollë	Gjithsejtë
Nr. i punëtorëve	2	14	25	40	217	33	1	332
Kualifikimi në %	0.60	4.22	7.53	12.05	65.36	9.94	0.30	100.00

- Ne baze te nenit 69, paragrafi 1 i Ligjit te punës Nr 03/L-212 i Republikës se Kosovës, kontratën e punës me vet dëshirë e kanë ndërpre këta punëtor:
 - A.Capo – me pozite te punës Detektues ne njësinë punuese Prizren me datë 04.10.2021,
 - G.Bytyqi - me pozite te punës Arkëtar ne njësinë punuese Prizren, me datë 27.10.2021,
 - A.Canaj - me pozite te punës Lexues ne njësinë punuese Suhareke, me datë 01.12.2021,
- Nga konkurset e publikuar gjatë muajit gusht dhe shtator 2021 janë punësuar 6 punëtor ne kompani gjatë TM4, prej tyre 2 janë në njësinë e Suharekës, 1 ne njësinë e Malishevës, 3 ne njësinë e Prizrenit.

- Pas kërkesës së Menaxherit Teknik me numër protokoll 3070 të datës 26.11.2021, e aprovuar nga U.D. Kryeshefi Ekzekutiv dhe Zyrtar Kryesor Financiar dhe i Thesarit, është bërë ngritja e koeficientit për gjashtë inxhinier dhe një ndihmës gjeodet të shërbimit teknik në kompani, prej datës 01.12.2021.

PËRFAQËSIMI NË GJYKATA - TM4 -2021

Tabela:21

Muaji	Seanca përgatitore	Seanca kryesore	Seanca të shtyra	Ndërmjetësim	Vërejtje
Tetor	/	/	/	/	/
Nëntor	2	/	/	/	2
Dhjetor	3	/	2	/	5
Totali	5	/	2	/	7

Tabela:22 TABELA PËR RAPORTET E PUNËS

	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali
Aprovime të pjesërishtme	9	8	/	17
Aktvendime në favor të Kompanisë	3	3	/	6
Aktvendime kundër Kompanisë	/	/	/	/
Me përfaqësues	/	2	1	3
Thirrje për seanca	/	1	/	1
Aktvendime urdhërohen debitorët	/	/	/	0
Korrigjime të Aktvendimeve	/	1	/	1
Aktvendime E.nr.	/	/	/	/
Aktgjykime për Kallëzime Penale në favor të Kompanisë	/	1	2	3
Aktgjykime për Kallëzime Penale kundër Kompanisë	/	/	/	/
Aktvendime për Kallëzime Penale në favor të Kompanisë	/	/	/	/
Aktvendime për Kallëzime Penale kundër Kompanisë	1	/	1	
Me ndërmjetësim	/	/	/	/
Kallëzime Penale	/	21	1	22
Kallëzime Penale me marrëveshje	/	/	2	2
Kallëzime Penale të përfunduara	/	1	/	1
Ftesë nga Prokuroria	/	/	/	/
Padi nga Kompania	2	/	/	2
Padi kundër Kompanisë	1	/	/	1
Përgjigje në Padi	1	/	/	1
Tërheqje e Padive	/	/	/	/
Ekspertizë në favor të Kompanisë	/	/	/	/
Ekspertizë në dëm të Kompanisë	/	/	/	/
Revizion	/	/	/	/
Përgjigje në Revizion	/	/	/	/
APELI				
Aktgjykim në favor të kompanisë	/	/	/	/

Aktgjykim kundër kompanisë	/	1	/	1
Aktvendime në favor të kompanisë	/	1	1	2
Aktvendime kundër kompanisë	/	1	/	1
Ankesa	2	/	/	2
Përgjigje në Ankesë	1	1	/	2
Konkluzione të ndryshme	1	/	/	/
Konkluzione për njoftime të gjykatave	/	/	/	/
Njoftime dhe Kërkesa	/	/	/	/
Urdhëresë për pagesë të Garancisë	/	/	/	/
Ujdi Gjyqësore	/	/	/	/
Pagesë të Taksës Gjyqësore	1	/	/	1

Tabela:23 LËNDËT TË CILAT JANË NË PROCEDURA GJYQËSORE DHE TË CILAT E KËRCËNOJNË KOMPANINË

Nr.	C.nr.	Kontesti	Vlera	Vërejtje
1.	C. nr. 116/03, datë 08.05.2013	Padi për kompensim dëmi	Dëmshpërblimi ende i pacaktuar	Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë
2.	C.nr. 286/14, datë 03.06.2015	Padi – Kontest nga marrëdhënia e punës	Dëmshpërblimi ende i pacaktuar	Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë
3.	A.nr. 420/2015, datë 03.04.2017	Padi – Kontest lidhur me borxhin e ujit	Kontest administrativ	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prishtinë
4.	C.nr. 170/18, datë 14.09.2018	Padi – kompensim dëmi	Vlera e kontestit 1,170.00 €	Gjykata Themelore e Prizrenit me Aktgjykim e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, dhe tani Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit në Prishtinë.
5.	C.nr. 471/2017, datë 06.10.2017	Padi – kompensim dëmi	Vlera e kontestit 3200.00 €	Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë
6.	C.nr. 416/18, datë 24.05.2018	Padi – Kontest pronësor	Vlera e kontestit 500 €	Gjykata Themelore e Prizrenit me Aktgjykim e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, dhe tani Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit në Prishtinë.
7.	C.nr. 99/16, datë 06.03.2018	Padi – Kontest pronësorë	Vlera e kontestit 10,000 €	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren – dega Dragash
8.	C.nr. 364/16, datë 12.10.2016	Padi – Kontest pronësorë	Vlera e kontestit 3200 €	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren – dega Suharekë
9.	C.nr. 745/05 05.09.2005	Padi për kompensim dëmi	27.350 €	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren

	C.nr. 68/17 (Nr. i ri) 08.10.2015			
10.	CP.nr. 1024/2020 14.09.2020	Aktvendim sipas të cilit Refuzohet si i pabazuar propozimi për përmbarrim i propozuesit të përmbarrimit ish KE për kthim në punë.	/	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren
11.	C.nr. 1030/20 27.07.2020	Padi Kontest nga Marrëdhënia e punës me propozim për caktimin e masës së sigurimit, kthimi në punë	3,100 €	21.08.2020, e kemi marrë nga Gjykata Themelore një Aktvendim sipas të cilit Themeloria e Refuzon Caktimin e Masës së Sigurimit, kthimi në punë për ish KE-në.
12.	C.nr.251/20 26.04.2021	Kompensim dëmi	Padi ndaj Kompanisë Fitim i pabazë , vlera 3.100 E	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren
13.	C.nr. 363/20 11.06.2021	Anulim i Vendimit Nr. 930, datë 06.05.2020, kompensimi i pushimit vjetor	E pa përcaktuar	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren –Dega në Suharekë

Lënda me Nr. Rendor 9, dhe me shenjë P. nr. 512/18, e datës 10.10.2019 me Aktakuzë për Lëndime të lehta trupore është kryer në favorin tonë, andaj kjo lëndë është larguar nga grupi i lëndëve që e rrezikojnë Kompaninë, dhe tani numri i lëndëve që rrezikojnë Kompaninë është 13 .

PROCEDURA PËRMBARIMORE

Tabela:24

	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali
NJËSIA PUNUESE PRIZREN				
PROPOZIME PËR PËRMBARIM	13	66	51	130
PRAPËSIME	4	4	8	16
PËRGJIGJE NË PRAPËSIME	4	4	8	16
MARRËVESHJE	12	13	20	45
TË PËRFUNDUARA	9	6	10	25
ANKESË NË GJYKATËN E APELIT	/	/	/	/
PËRGJIGJE NË ANKESË	/	/	/	/
TËRHEQJE	1	/	1	2
LËNDËT E NGELURA PEZULL	/	/	/	/
ME PËRFAQËSUES	1	1	2	4
NJËSIA PUNUESE SUHAREKË				

PROPOZIME PËR PËRMBARIM	12	/	20	32
PRAPËSIME	/	/	1	1
PËRGJIGJE NË PRAPËSIME	/	/	1	1
MARRËVESHJE	3	/	3	6
TË PËRFUNDUARA	1	/	/	1
ANKESË NË GJYKATËN E APELIT	/	/	/	/
PËRGJIGJE NË ANKESË	/	/	/	/
TËRHEQJE	/	/	/	/
LËNDËT E NGELURA PEZULL	/	/	/	/
ME PËRFAQËSUES	/	/	/	/
NJËSIA PUNUESE MALISHEVË				
PROPOZIME PËR PËRMBARIM	/	/	/	/
PRAPËSIME	/	/	/	/
PËRGJIGJE NË PRAPËSIME	/	/	/	/
MARRËVESHJE	/	1	/	1
TË PËRFUNDUARA	/	/	3	3
ANKESË NË GJYKATËN E APELIT	/	/	/	/
PËRGJIGJE NË ANKESË	/	/	/	/
TËRHEQJE	/	/	/	/
LËNDËT E NGELURA PEZULL	/	/	/	/
ME PËRFAQËSUES	/	/	/	/
NJËSIA PUNUESE DRAGASH				
PROPOZIME PËR PËRMBARIM	/	/	/	/
PRAPËSIME	/	1	/	1
PËRGJIGJE NË PRAPËSIME	/	/	/	/
MARRËVESHJE	/	/	/	/
TË PËRFUNDUARA	/	1	3	4
ANKESË NË GJYKATËN E APELIT	/	/	/	/
PËRGJIGJE NË ANKESË	/	/	/	/
TËRHEQJE	/	/	/	/
LËNDËT E NGELURA PEZULL	/	/	/	/
ME PËRFAQËSUES	/	1	/	/

Aktivitetet e Zyrtarit për siguri dhe shëndetin ne punë

Gjatë TM-4 janë realizuar vizita në objektet e Kompanisë lidhur me mirëmbajtjen dhe gjendjen tyre, janë vizituar të gjitha objektet në njësinë punuese në Prizrenit, siç janë objekti i “Rezervari i shpatit”, “Filtrat”, “Kuagulatorët”, objektet të “Mulliri i vjetër”, objektet e “40 Burimeve I”, objekti dhe “40 Burimeve II” ku janë kontrolluar gjendja e tyre, pastërtia dhe mirëmbajtja e objekteve si dhe hapësira për rreth objekteve.

Gjatë kësaj periudhe është bërë edhe planifikimi i nevojave për shërbimin e sigurisë dhe shëndetit në punë për vitin fiskal 2022.

Kompania e “Hidroregjonit Jugor” për shkak të situatave të krijuara në Kosovë me rritjen e numrit të prekurve nga Covid-19 si dhe me rekomandimin e Qeverisë së Kosovës kemi marrë masa shtesë në parandalimin e përhapjes së Covid-19, ku kemi identifikuar të gjithë punëtorët rreth dokumenteve për vaksinim ose dëshmi tjera sipas vendimit të Qeverisë së Kosovës.

Gjatë kësaj periudhe janë përgatitur paramasat për Dezinfektim, Deratizim dhe Dezinsektim – DDD të objekteve të Hidroregjonit jugor për Prizren, Malishevë, Suharekë dhe Dragash, si dhe janë paraqitur paramasat për furnizim me materiale mbrojtëse kundër covid-19 si maska, dezinfektues dhe shërbime tjera.

Gjatë TM4 përkatësisht në muajin Nëntor kompania e Hidroregjonit Jugor ka zhvilluar procedurat tenderuese për shërbime dhe furnizim me materiale mbrojtjes kundër covid-19 ku është shpallur tenderi dhe është përzgjedhur firma fituese për DDD.

Gjatë tremujorit të katërt nga u.d. Kryeshefit me vendim është emëruar Menaxheri i kontratës nr.H21-019-136 -për Dezinfektimin, Deratizimin, dhe Dezinsektimin e objekteve të kompanisë me tri njësit punuese Malishevë, Suharekë dhe Dragash, dhe sipas procedurave është filluar me plotësimin e dokumentacionit për furnizim.

Gjatë kësaj periudhe me kërkesa të menaxherëve të njërive punuese janë porositur materiale për mbrojtjen nga Covid-19 sipas procedurave të kontratës andaj pas furnizimit i janë njoftuar të gjitha shërbimet të furnizohen me materiale mbrojtës nga Covid-19.

Gjatë TM/4 përkatësisht në muajit dhjetor kompania është furnizuar me materiale mbrojtës kundër covid-19 sipas procedurave; Furnizim me Dezinfektues për duar, furnizim me maska, furnizim me dorëza, si dhe furnizim me dezinfektues , ku të gjitha këto materiale janë dorëzuar në depon e Kompanisë, që pastaj është bërë shpërndarja neper njësi punuese dhe objektet e kompanisë.

Në këtë TM/4 me kërkesën e Menaxherit të impiantit të ujërave të zeza gjatë muajit dhjetor është bërë DDD tek impianti dhe në hapësirat për rreth ujërave të zeza.

Gjatë këtij tremujori nuk kemi pasur asnjë punëtorë të prekur me Covid-19, në KRU “Hidroregjioni Jugor” nga fillimi i pandemisë deri me tani 49 punëtorë kanë qenë të prekur nga Covid-19.

Në këtë periudhë është bërë vlerësimi i punës për shefin e Sigurimit Fizike të Objekteve dhe Administrator i Rojeve për vitin 2021 si dhe janë bërë vlerësimet edhe për të gjithë punëtorët roje.

Gjatë kësaj periudhe kemi bërë kontrollimi i punëtorëve të shërbimit operativ lidhur me eliminimin e defektit në pjesët e ndryshme të qytetit të Prizrenit.

Në bazë të përgjegjësive dhe detyrave të punës janë monitoruar vazhdimisht të gjithë punëtorët që punojnë në sportele, leximin e ujëmatësve, rojet, ekipet e kontrolluese, zyret e përbashkëta etj, të kenë kujdes për përdorimin e masave mbrojtëse personale sidomos për përdorimin e dezinfektuesve dhe të maskave mbrojtës.

Gjatë kësaj periudhe të TM-4 janë realizuar vizita/kontrolla të vazhdueshme brenda dhe jashtë orarit edhe nga Shefit të Sigurimit Fizik të Objekteve dhe Administrator i Rojës në kohë të pacaktuar nëpër të gjitha objektet të cilat sigurohen nga kujdestaret – roje gjatë 24/h, në të gjitha pikat e njësisë së Prizrenit:40 Burime, Mulliri i vjetër, rezervari Shpati, Bunari1, objektet e Drejtorisë, Kuogulatorët etj.

Janë përpiluar oraret e punës për të gjithë punëtorët kujdestar/roje për TM-4/2022, ku edhe është bërë shpërndarja në të gjitha objektet ku kujdestarohen gjatë **24h**, në Prizren.

Gjatë muajit dhjetor është organizuar trajnim për punëtorët të cilët merren me klorifikimin e ujit, ku 11 punëtor nga sektori ynë, kujdestar roje kanë marr pjesë në këtë trajnim me titull “Dezinfektimi dhe klorifikimi i ujit të pijes”.

Gjatë TM-4 kam vizituar edhe njësinë punuese në Malishevë ku vizitua objektin e stacionit të pompave në fshatin Banjë, objektin e administratës në Malishevë dhe stacionin e pompave në fshatin Burim, ku çdo gjë ishte në rregull si më parë.

Në këtë tremujor në disa prej objekteve të cilat sigurohen nga kujdestaret roje, kemi pasur ndërprerje të vazhdueshme të rrymës, ku është dashur të bëhet një organizim më i madh rreth sektorit me atë të sektorit operativ–elektracistëve.

PROBLEMET GJATË PROCESIT TË PUNËS

Vazhdojnë të jen problem lëndët e lartcekura të cilat e kërcënojnë Kompaninë, kemi lëndë që kanë të bëjë me kontest nga marrëdhënia e punës, lëndë që kanë të bëjnë kompensim dëmi, kontest pronësor dhe kontest lidhur me borxhin e ujit .

Gjatë procesit të punës Zyra Ligjore ballafaqohet me probleme të natyrave të ndryshme, ndër të cilat mundë ti përmendim:

Ligjin mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, respektivisht Neni 360, Paragrafi 1, Nënparagrafi 1.1, e parasheh afatin njëvjeçarë të parashkrimit për ujë të pijes, me ç`rast kompanisë po i shkakton dëme të konsiderueshme materiale, pasi që gjykata në shumicën e Vendimeve të cilat po i merr po thirret pikërisht në këtë dispozitë, ndërsa kompania për këto borxhe ka qenë e ngarkuar dhe ka paguar TVSH.

Deri te përmbarimi i lëndës përmbaruesi has në probleme të ndryshme duke filluar nga gabimet në evidentimin e konsumatorëve, ku në propozim për përmbarim figuron emër tjetër, ndërsa shfrytëzues i shërbimeve të ujit është person krejt tjetër.

Mungesa e numrave personal gjithashtu ndikon në vonesa për përmbarimin e lëndëve.

Pasaktësia e adresave të vendbanimit të konsumatorëve gjithashtu ndikon në vonesa për përmbarimin e lëndëve.

Faturimi në emra të vdekurve, sjellë humbje kohe dhe probleme tjera përcjellëse, pasi që të njëjtëve duhet të ju caktohen përfaqësues të përkohshëm.

Kyçjet ilegale të konsumatorëve për kompaninë janë të kushtueshme, mirëpo Vendimet e gjykatave në aspektin e disiplinimit të konsumatorëve kanë dhënë rezultate pozitive edhe pse ato ende janë rezultate fillestare.

Rastet sociale të konsumatorëve gjithashtu na paraqesin problem, sepse neve jemi të detyruar që ti tërheqim propozimet për përmbarim kur bëhet fjalë për rastet e rënda sociale, e që shpenzimet për taksat e përmbarimit bien mbi kompaninë.

Propozim për zgjidhjen e problemeve

Sipas Zyrës Ligjore për tu zgjidhur problemet e lartcekura, nevojitet angazhim i të gjithë punonjësve dhe në veçanti angazhimi i lexuesve pasi që janë në kontakte të rregullta me konsumatorët. Faktori kryesor

përgjegjës për ti ikur parashkrimit të borxheve ndaj kompanisë do të ishte që të njëjtit të i bindin konsumatorët që të paguajnë të paktën një pagesë nga borxhi i krijuar brenda vitit kalendarik nga konsumatori, ndërsa sa i përket eliminimit të problemit lidhur me konsumatorët e vdekur, ne propozojmë se zgjidhja më e mirë do të ishte shkyçja nga rrjeti i ujësjellësit nëse pasardhësi nuk pranon të kalojë borxhi në emër të tij.

PUNËT E REALIZUARA NGA TM PARAPRAK

Vlerësoj se Departamenti Administrativ ka bërë një përmbyllje të kënaqshme të TM4-2021, janë realizuar të gjitha obligimet ligjore të parapara në detyrat e punës si përgjegjësi kryesore dhe në statutin e Kompanisë.

Janë respektuar Politikat e Kompanisë për Procedimin për Përmbartim të Borxheve të Konsumatorëve të cilët nuk i paguajnë faturat e tyre ndaj Kompanisë për shërbimet e ofruara, për Arkëtimin e të gjitha faturave të pakontestueshme për shërbimet e ofruara.

SYNIMET E DEPARTAMENTIT ADMINISTRATIV

Synim i Departamentit Administrativ është përcjellja dhe zbatimi i të gjitha ligjeve dhe ndryshimeve eventuale që kanë të bëjnë me funksionalizimin sa më të mirë të kompanisë.

Mbetet që në vazhdimësi të punohet në Përpilimin e rregulloreve të nevojshme, për rregullimin e politikave dhe procedurave të përgjithshme të KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh. A, duke u bazuar në nevojën për suksesin e mbarëvajtjeve të punëve në Kompani si dhe propozimeve të dala nga Menaxhmenti, Bordi i Drejtorëve dhe Aksionari-Qeveria e Republikës së Kosovës.

Përfaqësim sa më të mirë në Gjykatë dhe Institucionet kudo që do të paraqitet nevoja.

Të vazhdojmë me nxjerrjen e Akteve të reja, korrigjimet, eventuale të Akteve ekzistuese ku vërejmë se ka vend për intervenime, pastaj të bëjmë ndryshime dhe plotësime të Akteve të brendshme të Kompanisë sipas kërkesave Ligjore.

V RAPORT I AUDITORIT TË BRENDSHËM

Raporti në vijim paraqet përmbledhjen dhe prezentimin e punëve dhe aktiviteteve të auditorit të brendshëm, të realizuara gjatë tremujorit të katërt të këtij viti (TM4/2021), gjegjësisht raport i punës për periudhën kohore tetor – dhjetor 2021.

Duhet theksuar se në pajtim me planin vjetor të punës së auditimit për vitin 2021, si dhe bazuar në kërkesën shtesë për auditim, janë realizuar gjithsejt 5 auditime në subjekte të ndryshme brenda kompanisë, sikurse janë auditimet lidhur me:

- Menaxhimin e procesit të prokurimit;
- Menaxhimin e procesit të faturimit dhe inkasimit në NjP në Prizren;
- Menaxhimin e transportit – procesin e përdorimit të automjeteve zyrtare NjP. Prizen;
- Menaxhimin e procesit të servisimit, kalibrimit dhe vendosjes së ujëmatësve, si dhe
- Menaxhimin e procesit të financimit të projektit “ITUN” nga Ministria e Ekonomisë.

• Pas përfundimit të auditimeve, në pajtim me procedurat e punës dhe standardet e auditimit të brendshëm është bërë:

- përgatitja e draftraporteve,
- mbajtja e takimeve me subjektet e audituara,
- diskutimi i të gjeturave dhe rekomandimeve, si dhe
- finalizimi i raporteve.

• Duke u bazuar në testimet e kryera dhe të gjeturat e auditimeve të kësaj periudhe tremujore, është konstatuar se në përgjithësi menaxhimi i proceseve është kryer:

- në pajtim me dispozitat ligjore,
- është treguar një performancë e mirë e shërbimeve, si dhe
- është konstatuar një funksionim i mirë i kontrollit të brendshëm.

• Gjatë auditimit të disa proceseve, janë konstatuar edhe mangësi, ku dhe janë dhënë rekomandime të cilat mbeten të realizohen. Detajisht janë të prezentuara në raportet finale të këtyre auditimeve, të cilat i janë bashkangjitur këtij raporti.

• Gjithashtu gjatë kësaj periudhe është bërë rishikimi i adresimit të rekomandimeve të auditimeve të realizuara gjatë periudhës kohore TM3/2020, gjegjësisht periudhës tremujore korrik – shtator 2020, sikurse:

- Menaxhimi i procesit të faturimit dhe inkasimit në Njësinë Punuese në Suharekë,
- Menaxhimi i procesit të faturimit dhe inkasimit në Njësinë Punuese në Malishevë,
- Menaxhimin i procesit të faturimit dhe inkasimit në Njësinë Punuese në Dragash, si dhe
- Menaxhimi i procesit të përgatitjes dhe realizimit të Planit të Biznesit të kompanisë.

VI. PROCEDURAT E PROKURIMIT - TM4 2021

Tabela:25

Titulli i kontrates	Nr.Prokurimit	Data e nenshkrimtit	Data e skadimit	Operatori Ekonomik	Vlerat e kontrates	Verejtje
Denzinfektimin,Deratizimin dhe Dezinsektimin e objeteve te KRU Hidroregjioni Jugor SH.A Prizren se bashku me njesit pounuese ne Suhareke ,Malisheve dhe Dragash	HJ-21-009-221					Në Apel
Furnizim me Aparate per hyrje-daljet e punëtorëve nga puna, neper objektet e KRU-së si dhe furnizim me nje printer per shtypje të ID-kartelave.	HJ-21-010-136					Anulim
Ritender: Furnizim me Aparate per hyrje-daljet e punëtorëve nga puna, neper objektet e KRU-së si dhe furnizim me nje printer per shtypje të ID-kartelave.	HJ-21-010-136					Anulim
Ritender 2: Furnizim me Aparate per hyrje-daljet e punëtorëve nga puna, neper objektet e KRU-së si dhe furnizim me nje printer per shtypje të ID-kartelave.	HJ-21-010-136					Anulim
Ritender 3: Furnizim me Aparate per hyrje-daljet e punëtorëve nga puna, neper objektet e KRU-së si dhe furnizim me nje printer per shtypje të ID-kartelave.	HJ-21-010-136	01.10.2021	30 dite nga data e leshimit te urdher blerjes se AK-se	“AXA” SH.P.K Tringe Smajli nr.1/57 Prishtine	9,990.00€	
Ndertimi i sportelit për konsumatorë.	HJ-21-011-136	18.06.2121	5 ditë pas nënshkimit të kontratës	4ING ” sh.p.k	1934,30 €	
Servisimi dhe Furnizimi me materiale shpenzuese të fotokopjeve ekzistuese të Kompanisë	HJ-21-013-136	19.07.2021	5 dite nga data e leshimit te urdher blerjes se AK-se	Miri Print SHPK	3 900,00€	
LOT I:Rehabilitimi i rrjetit te ujesjellesit ne fshatin Peqan LOT II:Lagjia Plishi –Greikoc	HJ-21-014-521	01.09.2021	30 dite nnga data e kerkeses se njesise kerkuese	LOT II: Lagjia Plishi –Greikoc “Puna” Shpk Brrut –Dragash	27 975,00€	
Lot I Furnizimi, montimi, ndërtimi dhe puna e dorës me materiale për objekte të ndryshme dhe punë në teren sipas nevojave të KRU Hidroregjioni Jugor Sh.A per zonen e Prizrenit	HJ-21-015-521					Ne fazen e vleresimit

dhe Dragashit. Lot II Furnizimi, montimi, ndërtimi dhe puna e dorës me materiale për objekte të ndryshme dhe punë në teren sipas nevojave të KRU Hidroregjioni Jugor per zonen Suharekë, Malisheve dhe Mamushe.						
Lot I Furnizimi, montimi, ndërtimi dhe puna e dorës me materiale për objekte të ndryshme dhe punë në teren sipas nevojave të KRU Hidroregjioni Jugor Sh.A per zonen e Prizrenit dhe Dragashit	HJ-21-015-521	23.12.2021	28.12.2022	RITENDER:LOT I Furnizim,montimi ,ndertimi dhe puna e dores me materiale per objekte te ndryshme dhe pune ne teren sipas nevojave te KRU "Hidroregjionit Jugor" per zonen e Prizrenit dhe Dragashit	60,000.00€	
Lot II Furnizimi, montimi, ndërtimi dhe puna e dorës me materiale për objekte të ndryshme dhe punë në teren sipas nevojave të KRU Hidroregjioni Jugor per zonen Suharekë, Malisheve dhe Mamushe.	HJ-21-015-521	23.12.2021	28.12.2022	RITENDER:LOT II Furnizim,montimi ,ndertimi dhe puna e dores me materiale per objekte te ndryshme dhe pune ne teren sipas nevojave te KRU "Hidroregjionit Jugor" per zonen eSuharekes,Malisheves dhe Mamushe	40,000.00€	
Furnizim me klima	HJ-21-016-136	10.09.2021	5 dite nga data e leshimit te urdher blerjes se AK- se	"AS TECH " SHPK	2,610.00€	
RITENDER:Reagjent per analizat e mostrave te ujrave te ndotura ne impiantin qendror ITUN ne Prizen	HJ-21-017-136	27.09.2021	30 dite nga data e kerkeses se njesise kerkuese	Vitech SHPK Rr.Vicianum nr.210 Prishtine	748,32€	
Rehabilitimi i Gypit te ujesjellesit PEHD O 160mm,ne Malisheve	HJ-21-018-521	02.09.2021	25 dite nga data e kerkeses se njesise kerkuese	"KING" SHPK	34 970,02€	
Furnizim me pjese per bashkimin e zorreve cisternes ,pastrimin e kanaleve dhe zorreve per Eskavator 350 BAR	HJ-21-020-136	04.10.2021	10 dite nga data e kerkeses se njesise kerkuese	Bahri Çabrati B.I. Jonit 59/A Prizren	6 100,00€	
Sherbim me internet dhe DTV ne pikat e kompanise se KRU "Hidroregjioni Jugor" sh.a 6 lote LOT I -Zyret Qendrore Kurille-Shadervan Koagulim Filtra Abi Plus Abi Qarshia Bajram Curri Lagjja Jeta e Re Depo Shpati Gjonaj Nashec Suhareke z.qendrore Suhareka (RIA) Malisheva z.qendrore Malisheva Komune,Malisheve fshati Banje Dragash z.qendrore Dragash Filtra	HJ-21-021-221	03.12.2021	12.12.2023	Lot I "Ipko Telecommunications	7,186.56€	

Sherbim me internet dhe DTV ne pikat e kompanise se KRU "Hidroregjioni Jugor" sh.a 6 lote LOT II-Kojush 1 Kojush 2	HJ-21-021-221	03.12.2021	12.12.2023	AE HOLDING L.L.C	1,200,00€	
Sherbim me internet dhe DTV ne pikat e kompanise se KRU "Hidroregjioni Jugor" sh.a 6 lote LOT III 40 Burimet dhe 40 Burimet 2	HJ-21-021-221	30.09.2021 Anulim				
Sherbim me internet dhe DTV ne pikat e kompanise se KRU "Hidroregjioni Jugor" sh.a 6 lote LOT IV Pusi Atit	HJ-21-021-221	30.09.2021 Anulim				
Sherbim me internet dhe DTV ne pikat e kompanise se KRU "Hidroregjioni Jugor" sh.a 6 lote LOT V Novak	HJ-21-021-221	03.12.2021	12.12.2023	Lot V "Ipko Telecommunications	216.00€	
Sherbim me internet dhe DTV ne pikat e kompanise se KRU "Hidroregjioni Jugor" sh.a 6 lote LOT VI Baqevc	HJ-21-021-221	03.12.2021	12.12.2023	Lot VI "Ipko Telecommunications	216.00€	
Furnizim me kater aparate mobile	HJ-21-022-136	28.10.2021	16.12.2021	N.N.SH "A& E COM"	1,500,00€	
Furnizim me dru	HJ-21-023-136	25.10.2021	26.11.2021	NDERMARRJA TREGTARE SHERBYESE "TINI"	1,798.8€	
Furnizim me makina zyrtare per ushtrimin e aktiviteteteve te perditshme ne teren nga ekipet operative LOT I- Furnizim me 3 automjete te vogla	HJ-21-024-121					ANULUAR
Ritender-Furnizim me makina zyrtare per ushtrimin e aktiviteteteve te perditshme ne teren nga ekipet operative LOT I- Furnizim me 3 automjete te vogla LOT II-Furnizim me 2 kamioneta me kiper	HJ-21-024-121					ANULUAR
Ritender2-Furnizim me makina zyrtare per ushtrimin e aktiviteteteve te perditshme ne teren nga ekipet operative LOT I- Furnizim me 3 automjete te vogla LOT II-Furnizim me 2 kamioneta me kiper	HJ-21-024-121					Ne vleresim
Sigurimi I automjeteve	HJ-21-025-236					ANULUAR
RITENDER-Sigurimi I automjeteve	HJ-21-025-236					Ne procedur
Rehabilitimi I gypit PEHD O 110mm,ne rrugen TREPÇA	HJ-21-027-521	22.12.2021	04.11.2021	"K-ING" SHPK	53,065.12€	
Furnizim me 17 cope aparate per lexim te barkodeve te faturave	HJ-21-028-136	22.12.2021	28.12.2021	Comtrade Computers O.K	3,481.16€	
Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit PEHD O 90 mm,	HJ-21-029-536					Ne procedur

në fshatin KOBAJ - Prizren.						
Shërbime të veçanta Kontabilist i Certifikuar	HJ-21-030-236					Ne procedur
Kontrollimi teknik i automjeteve	HJ-21-031-236					Anuluar ne mungese te ofertuesve

STRUKTURA ORGANIZATIVE
KRU „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A. PRIZREN

